VENDIM
Nr. 271, datë 4.5.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RRUGA E RE E VARREZAVE ELBASAN DHE NDËRTIMI I NËNKALIMIT HEKURUDHOR NË KRYQËZIMIN E RRUGËS NACIONALE ELBASAN–LIBRAZHD ME RRUGËN 'BORODIN MITARJA' DHE 'RIKONSTRUKSION DHE NDËRHYRJE NË LINJËN KUZ, NDËRTIMI I SHESHIT TË PARKIMIT TË VARREZAVE PUBLIKE DHE ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE"", BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rruga e re e varrezave Elbasan dhe ndërtimi i nënkalimit hekurudhor në kryqëzimin e rrugës nacionale Elbasan-Librazhd me rrugën 'Borodin Mitarja' dhe 'Rikonstruksion dhe ndërhyrje në linjën KUZ, ndërtimi i sheshit të parkimit të varrezave publike dhe zgjerimi i varrezave publike"", Bashkia Elbasan.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 9 303 354 (nëntë milionë e treqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e katër) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 303 354 (nëntë milionë e treqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e katër) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.
8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA E PRONARËVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RRUGA E RE E VARREZAVE ELBASAN DHE NDËRTIMI I NËNKALIMIT HEKURUDHOR NË KRYQËZIMIN E RRUGËS NACIONALE ELBASAN–LIBRAZHD ME RRUGËN 'BORODIN MITARJA' DHE 'RIKONSTRUKSION DHE NDËRHYRJE NË LINJËN KUZ, NDËRTIMI I SHESHIT TË PARKIMIT TË VARREZAVE PUBLIKE DHE ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE"", BASHKIA ELBASAN

NR.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							TË DHËNAT E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN				(KUFIZIME HIPOTEKARE)
											ARË			VLERA TOTALE (lek)	
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)	VLERA TOTALE (lek)	
1	Lindita	Ibrahim	Myzyri	Elbasan	8522	18/24	Arë	13200	9	147	9,722	222	2,158,284	2,158,284	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Jonaid	Abdyl	Myzyri												
	Hatixhe	Adem	Zenelhoxha												
	Aida	Adem	Kacollja												
	Gazmend	Adem	Zenelhoxha												
	Ymer	Kadri	Myzyri												
	Sokol	Kadri	Myzyri												
	Irma	Naim	Haxhihyseni												
	Adile	Naim	Çelirama												
	Zvjetlana	Ali	Garunja												
	Zhuljeta	Ali	Zhika												
	Haki	Ali	Kotherja												
	Edmonda	Ali	Pepa												
	Ilirjan	Ali	Kotherja												
2	Osman	Haxhi	Fejzo	Elbasan	8522	18/4	Arë	8000	9	134	4,938	222	1,096,236	1,096,236	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Xhaferr	Mustafa	Karadaku	Elbasan	8522	18/2	Arë	1200	9	135	155	222	34,410	34,410	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Ruzhdie		Peza												
	Zyba		Osmanaj												
4	Abdyl	Ibrahim	Qatipi	Elbasan	8522	18/1	Arë	6000	9	130	2,910	222	646,020	646,020	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Emin		Kacadei	Elbasan	8522	18/25	Arë	8000	9	149	8,000	222	1,776,000	1,776,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Abdurraman	Mehmet	Beluli	Elbasan	8522	18/23	Arë	8000	9	146	8,000	222	1,776,000	1,776,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	Nada	Ali	Skikuli	Elbasan	8522	18/157	Arë	8182	33	232	8,182	222	1,816,404	1,816,404	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Agron	Skender	Haxhihyseni												
	Eduart	Skender	Haxhihyseni												
	Mamica	Sokol	Grabocka												
	Rezarta	Sokol	Grabocka												
	Tajar	Ali	Qerfozi												
VLERA TOTALE											**41,907**		**9,303,354**	**9,303,354**	